



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 05.12.2016

Vendim
Nr. 77, datë 05.12.2016

PËR MIRATIMIN E NGRITJES SË RRJETIT TË STUDIUESVE SHQIPTARË
NË DIASPORË (RSSHD)

Mbështetur në nenin **38** në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin **11** në Statutin e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, nenin **14** në Rregulloren e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.12.2016

VENDOSI:

- 1.** Të miratojë ngritjen e Rrjetit të Studiuesve Shqiptarë në Diasporë (RSSHD) sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 2.** Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

PËR NGRITJEN E RRJETIT TË STUDIUESVE SHQIPTARË
NË DIASPORË (RSSHD)

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në kuadër të ndjekjes së politikave shtetërore për reformimin e arsimit të lartë, duke u mbështetur në Ligjin e ri të Arsimit të Lartë (80/2015) dhe duke pasur parasysh domosdoshmërinë dhe rëndësinë e ristrukturimit të hallkave arsimore në arsimin universitar, ndërmerr nismën e krijimit të Rrjetit të Studiuesve Shqiptarë në Diasporë (RSSHD).

Në zbatim të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit dhe Kartës Evropiane të Kërkuesve, RSSHD-ja ka në thelb të gjitha format e shkëmbimeve (mobiliteteve) si mjet për zgjerimin e karrierës profesionale të kërkuesve.

RSSHD-ja shihet si një urë bashkëpunimi në nivel universitar midis Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, universiteteve shqiptare si edhe të gjitha universiteteve të tjera në botë (diasporë), në të cilat punojnë shqiptarë të spikatur në mësimdhënie e kërkim shkencor, të cilat synojnë ndërveprimin e punës akademike dhe asaj shkencore brenda këtij rrjeti, në dobi të rritjes së cilësisë në universitet pjesëmarrëse në të.

Përveç shtysave të mësipërme (RSSHD)-ja vjen edhe si një reflektim dhe në koherencë me Samitin e Parë të Diasporës Shqiptare, ideuar dhe organizuar nga qeveria shqiptare nga data 18-20 nëntor 2016, seksioni “Të ndërtojmë rrjetin ndërshqiptar të aftësive” në të cilin u theksua bashkëpunimi/koordinimi i universiteteve shqiptare me eksperiencat personale e institucionale të kërkuesve dhe akademikëve shqiptarë në universitetet evropiane, amerikane, kanadeze, australiane, koordinim që synon të trajtojë e t’u japë përgjigje pyetjeve të tilla si: A mund të ndërtojmë një regjistër të aftësive shkencore brenda e jashtë vendit? A mund të krijojmë platforma bashkëpunimi profesionale efikase të cilat lehtësojnë shkëmbim informacioni dhe eksperience? Çfarë duhet të mësojmë nga eksperiencia e vendeve të tjera? Çfarë angazhimesh konkrete mund të marrin IAL-të ashtu edhe Diaspora për të vendosur praktika pune bashkëkohore në interes të dyanshëm.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Në këtë kontekst (RSSHD)-ja synon që në një afat kohor njëvjeçar (janar-dhjetor 2017) shtrirjen dhe marrëveshje me institucione akademiko-shkencore në nivel universitar me diasporën me qëllim:

- bashkëpunimin akademik dhe shkencor me të gjitha institucionet universitare në çdo lloj fushe me interes të përbashkët.
- shkëmbimin e këtyre përvojave ndërmjet anëtarëve institucional të rrjetit në fjalë.
- rritjen e mundësive të punësimit të studiuesve, si edhe nxitjen e tij, në frymën e domosdoshmërisë së ndërkombëtarizimit.
- përmirësimin e cilësisë kërkimore universitare me vlerë shkencore dhe zbatim të drejtpërdrejtë në çdo aspekt të jetës shoqërore, kulturore apo ekonomike.
- hapjen e programeve studimi të përbashkëta, në të tria ciklet, sipas legjislacioneve në fuqi në vendet përkatëse.
- organizimin e ngjarjeve, seminareve, kongreseve, apo konferencave ndërkombëtare në lëmin e studimeve me interes të përbashkët.
- çeljen e revistave shkencore të përbashkëta, botimin e librave shkencorë monografik/poligrafik me autorësi/bashkautorësi, si edhe çdo ndërmarrje tjetër akademike me vlerë botimi.
- shkëmbimin e stafit administrativ, akademik dhe studentor në forcim e ndërlidhjeve institucionale midis anëtarëve të rrjetit.
- zbatimin e çdo lloj marrëveshjeje në dobi të interesave dhe përfitimeve të përbashkëta.

RSSHD-ja shpreson për një shtrirje të këtij rrjeti në diasporë dhe afrimin e institucioneve të interesuara në të, për të përmirësuar aspekte të lëvizjes dhe punësimit të shkencëtarëve universitarë, cilësinë shkencore dhe pedagogjike, si edhe nxitjen e një larushie ndërkombëtarizimi. Shtysa për krijimin e RSSHD-së është gjithashtu edhe një nxitje e ndërmarrë në kuadër të politikave të Komisionit Evropian për një arsim universitar elitare, me qëllime të përbashkëta universitare midis popujve dhe përfitimeve arsimore dhe shkencore tek ta.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Qëllimi themelor i përfshirjes së UV-së në një rrjet të tillë akademik dhe kërkimor është për të përfutur eksperiencë universitare, mobilitete kërkuesish e studiuesish, njohje ndërkombëtare, pjesëmarrje dhe benefice të tjera shkencore e akademike.